

## SHTETI ËSHTË “ROJA NATËS”

*nga Muhamed KAVAJA – Kryeauditues,*

*botuar në gazetën “Koha Jonë”, më 13 shkurt 2015.*



Si çdo institucion i shtetit që në fund të çdo viti bën një analizë për arritjet e dobësitë në drejtim të objektivave të vendosura, edhe Institucioni i KLSH-së bëri analizën e punës së tij për vitin 2014, me qëllim përmirësimin e punës në të ardhmen.

Por ndryshe nga institucionet e shtetit që kanë synim të tregojnë performancën e tyre, duke bërë krahasime me paraardhësit dhe gjendjen e rëndë të institucioneve pas rotacionit, KLSH, siç e kemi shprehur dhe në shkrime të mëparshme, nuk krahasohet me paraardhësit, por vetëm me arritjet e veta, vit pas viti, në këtë periudhë tre vjeçare. Kjo kohë, tashmë, është e mjaftueshme për të nxjerr në pah arritjet e qëndrueshme, fakte të cilat shprehen dhe në konkluzionet e ndërkombëtarëve mbi punën e mirë të auditit të jashtëm në Republikën e Shqipërisë.

Postulati: “Kontrollin nuk e dëshiron njeri”, është i pranuar gjerësisht, si brenda dhe jashtë vendit, në të gjitha nivelet e nëpunësve që ushtrojnë

detyrën e auditimit. Është fjala për KLSH, që auditon në fushën e përputhshmërisë e të ligjshmërisë, si një lloj kontroll - revizioni. Por kur flitet për faktin e ligjit të sapo miratuar nga Kuvendi “Për Organizimin e Funksionimin e KLSH-së”, ku i është shtuar si mision dhe auditimi i performancës dhe sistemeve të IT, çështja bëhet më serioze për arsyen e thjeshtë se, personat që nuk do ta dëshironin kontrollin shtetëror, do të ishin pikërisht “high class” e drejtuesve të institucioneve, të cilët janë mësuar që, atë që ka të bëjë me tre “e”: “Ekonomicitetin”, “Eficiencën” dhe “Efektivitetin”, pra, performancën e përdorimit të fondeve, ta matnin vetë, ta raportnin vetë dhe të shpërblenin vetveten për arritjet duke krijuar dhe një lloj “deliri”, i cili të përfshinte të gjithë hallkat e shtetit.

Ka gati një çerek shekulli identifikimi i këtij fenomeni që përsëritet tek organet e qeverisjes qendrore dhe atyre vendore, por ka dhe një nevojë të domosdoshme të këtyre organeve publike për të kaluar në një auditim të plotë të veprimtarisë së tyre shtetërore bazuar në dispozitat e Kushtetutës së RSH dhe standardeve të auditimit të INTOSAI-t. Ishte pikërisht kjo edhe një nga arsyet e domosdoshme që Kryetari i KLSH-së të bashkëpunonte me organizmat ndërkombëtare, në të cilat KLSH aderon, për të paraqitur në Kuvend miratimin e ligjit të ri “Për organizimin e funksionimin e KLSH-së”, në të cilin përfshihet edhe auditimit i performancës dhe i sistemeve të IT.

Me këtë rast duhet përmendur edhe merita e Presidentit të Republikës, z.Bujar Nishani, i cili, jo vetëm ka qenë i angazhuar në mbështetje të ligjit të ri për KLSH, por edhe për rikthimin e këtij ligji në Kuvend, kohët e fundit, për ndryshime që lidhen me forcimin e pavarësisë së institucionit të KLSH, gjë, e cila, pavarësisht se nuk ndjehet e munguar sot për meritë të Kryetari të

KLSH, por ajo është diçka që i shërben institucionit të KLSH si një garanci e shtuar, si një rast juridik hipotetik për të cilën është shprehur, me të drejtë, Gjykata Kushtetuese, me vendim të vitit 2002.

Kërkesa për miratimin e ligjit të ri për KLSH nuk erdhi si objektiv për të qenë thjesht në letër, por erdhi si rezultat i punës këmbëngulëse tre vjeçare për modernizimin e institucionit të KLSH dhe forcimit të marrëdhënieve me institucionet homologe ndërkombëtare. Pra, e thënë në terma komercial, u punua e punohet përditë e më shumë në drejtim të Etikës, Integritetit e Profesionalizmit të audituesve, si dhe në drejtim të përgjegjshmërisë e paanësisë së institucionit në përmbushje të ligjshmërisë kushtetuese. Kjo punë, fatmirësisht, është e matshme me numrin e auditimeve të ushtruara dhe numrin e zbulimeve të dëmeve të shkaktuara shtetit, për të cilat janë tregues dhe kallëzimet penale të depozituara në Prokurori.

Në këtë shkrim, jam i vetëdijshëm se nuk bëhet fjalë për analizë krahasuese me analizat e zhvilluara si rutinë e përvitshme, apo për të treguar arritjet pompoze dhe faktin se qëndrueshmëria në arritje është më e rëndësishme se vetë arritja. Shqetësimi është se sfida e punës audituese e KLSH-së, në përmbushje të detyrimit ligjor (ligjit të ri të sapo miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë, në datën 29 janar 2015) për Auditim të Performancës, kërkon domosdoshmërisht një bashkëveprim e mirëkuptim të të gjithë institucioneve shtetërore me institucionin e KLSH-së.

Shteti është “roja i natës” - thotë Kanti. Kthimi në “gjumë” është rruga më e lehtë por e dhimbshme për publikun, taksapaguesit, që mendojnë se e kanë “rojen” zgjuar.